



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 12, datë 12.07.2019

PËR

MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT DHE NDRYSHIMIN E PROJEKTIT GJATË
NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “FABRIKA E PASURIMIT TË BAKRIT DHE
VENDDEPOZITIM I MASËS STERILE, SPAÇ, BASHKIA MIRDITË”


Në mbështetje të neneve 27, 28, 40 dhe 48 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit “Tete Albania Tunnel & Mining” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit dhe ndryshimit të projekti gjatë ndërtimit për objektin: “Fabrika e pasurimit të bakrit dhe venddepozitim i masës sterile, Spaç, Bashkia Mirditë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Tete Albania Tunnel & Mining” sh.p.k, miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit 16, datë 16.10.2017.
2. Harta e planvendosjes së strukturave bashkëlidhur Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit 16, datë 16.10.2017, zëvendësohet me hartën e planvendosjes së strukturave bashkëlidhur këtij Vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

